



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, Datë 21.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E QENDRËS
KOMBËTARE TË URGJENCAVE MJEKËSORE” BRENDA TERRITORIT TË
SPITALIT TË TRAUMËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencave Mjekësore”, brenda territorit të Spitalit të Traumës, Bashkia Tiranë, me subjekt aplikues Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore dhe kërkues Ministria e Shëndetësisë.
2. Ndërtimi duhet t’i përshtatet rregullave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, bazuar në legjislacionin sektorial në fuqi.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogaritë të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
6. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



ILIR BRQAJ

MINISTËR I SHËNDETËSISË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT